Financuar sipas marrëveshjes specifike të grantit nr. 2018/402-850 nga Programi me Shumë Përfitues EU IPA II për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë

Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor

Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës, Asistenca Teknike 9 (IPF9)

TA2018149 R0 IPA / AA-001107-001

WB20-ALB-ENE-01

VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL-PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

Projekti: Depozita Nëntokësore të Gazit Natyror në Dumre

16 korrik 2021

*) Ky përcaktim jepet pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të [illegible]9, dhe Opinionin e GJND-së lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës

Informacion rreth dokumentit

Instrumenti i Projektit në Infrastrukturë (IPF) është një instrument asistence teknike i Instrumentit për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF), që është një nismë e përbashkët e Bashkimit Evropian, Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, donatorëve dypalësh dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor dhe që mbështet zhvillimin social dhe ekonomik, si dhe anëtarësimin në BE në të gjithë Ballkanin Perëndimor përmes sigurimit të asistencës financiare dhe teknike për investime infrastrukturore strategjike. Ky operacion asistence teknike financohet me fonde të BE-së.

Deklaratë për mospranim përgjegjësie: *Autorët marrin përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e këtij raporti. Mendimet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërish pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose të Bankës Evropiane të Investimeve.*

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Kontrata	Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor, Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës, Asistenca Teknike 9 (IPF9), Infrastrukturat: Digjitale, Energji, Mjedis, Transport dhe Social
Numri i kontratës:	TA2018149 R0 IPA
Autoriteti Kontraktor:	Banka Evropiane e Investimeve
Kontraktori:	EGIS International (FR) / WYG International (NL) / WYG International Danismanlik Limited Sirketi (WYG Turkiye) (TR) / COWI A/S (DK) / COWI AS (NO) / GOPA Infra GmbH (DE) / GOPA — International Energy Consultants GmbH (DE) / CIS d.o.o. Beograd (RS) / TRENECON Consulting & Planning Ltd (HU) SYSTEMA Consulting SMLTD (GR) / Këshilli Danez i Refugjatëve (Danish Refugee Council) (DK) / SOFRECOM (FR)
Emri i nënprojektit	Depozita Nëntokësore të Gazit Natyror në Dumre: Studimi i Fizibilitetit dhe VNMS-ja:
Referenca e nënprojektit:	WB20-ALB-ENE-01
Përfituesit:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Mbështetësi:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Sektori:	Energji
Vendi:	Shqipëri
IFN-ja drejtuese:	BERZH
IPF 9 përgjegjëse:	IPF9
Data e fillimit të nënprojektit:	08.04.2020
Kohëzgjatja e nënprojektit:	19 muaj
Përfundimi i parashikuar:	13.11.2021

Ekspertët që kontribuan në këtë raport:	Klodian Aliu, Marijana Bakula, Marta Brkić, Etleva Bodinaku, Tomislav Hriberšek, Daniela Klaić Jančijev, Mario Pokrivač, Ines Rožanić, Tajana Uzelac Obradović
Menaxher Projekti për Sektorin:	Marko Krejči

HISTORIKU I NDRYSHIMEVE

Versioni	Data	Kontrolluar nga	Funksioni	Visa
V01	16 korrik 2021	Emri	xx	

Versioni	Data	Miratuar nga	Funksioni	Visa
V01	16 korrik 2021	Emri	xx	

PËRFITUESIT

Emri	Njësia
Z. Ilir Bejtja	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri
Znj. Sindi Dushku	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri
Z. Ilia Gjermani	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri
Z. Eral Trasja	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri
Z. Ardian Islami	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri
Z. Arber Avrami	ALBGAZ
Z. Alban Ibrahimi	ALBGAZ
Z. Laert Djogani	ALBGAZ
Znj. Elona Ajazi	KKI/Sekretariati Teknik pranë Kryeministrisë, Shqipëri
Z. Ilir Basha	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Znj. Amandine Tetot	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Z. Edvin Pecara	Delegacioni i Bashkimit Evropian
Z. Hubert Grandjean	Delegacioni i Bashkimit Evropian
Z. Ervis Sulejmani	Koordinator Kombëtar për IPA
Znj. Roza Dedja	IFICO
Z. Ralph Henderson	IPF9
Z. Ognjen Paleka	IPF9
Z. Marko Krejči	IPF9

TABELA E PËRMBAJTJES

1 - HYRJE 5

1.1 - Arsyetimi i Projektit: 5

1.2 - Qëllimi i Përmbledhjes Joteknike 5

1.3 - Përshkrimi i përmbledhur i projektit të propozuar 6

1.4 - Qëllimi i procesit të VNMS-së 6

2 - PREZANTIMI I PROJEKTIT DNG DUMREA 7

2.1 - Çfarë është projekti DNG Dumrea dhe ku ndodhet? 7

2.2 - Cilët janë komponentët/aktivitetet kryesore të Projektit? 7

3 - ANALIZA E ALTERNATIVAVE TË MARRA NË KONSIDERATË 12

4 - TË DHËNAT BAZË MJEDISORE 13

4.1 - Karakteristikat e mjedisit fizik 13

4.1.1 - Klima dhe meteorologjia 13

4.1.2 - Karakteristikat gjeologjike 13

4.1.3 - Gjeomorfologjia në zonat përreth DNG Dumrea 14

4.1.4 - Karakteristikat e peizazhit të mjedisit të gjerë rrethues 14

4.2 - Biodiversiteti dhe habitatet 14

4.3 - Cilësia mjedisore dhe ndikimet ekzistuese 15

4.3.1 - Cilësia e ujit 15

4.3.2 - Cilësia e ajrit 15

4.3.3 - Zhurma 15

4.3.4 - Menaxhimi i mbetjeve në zonën e projektit 15

4.4 - Baza socio-ekonomike 15

5 - SI DO TË NDIKOJË PROJEKTI NË MJEDIS DHE KOMUNITET? 17

6 - ZBUTJA DHE MENAXHIMI I NDIKIMEVE 22

6.1 - Programi i masave/monitorimit 24

7 - SI PO ANGAZHOHET PROJEKTI ME KOMUNITETET DHE PALËT E TJERA TË INTERESIT? 27

TABELA E FIGURAVE

Figura 1 – Vendndodhja e DNG-së së Planifikuar të Dumresë 8

Figura 2 – Kalendari i zbatimit të projektit 11

Lista e shkurtesave

SMT	Stacioni i matjes dhe transferimit
PMMSM	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social dhe i Monitorimit
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
EUNIS	Sistemi Evropian i Informacionit për Natyrën
SG	Stacioni i Gazit
SHS	Shëndeti dhe Siguria
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PJT	Përmbledhje Joteknike
PMP	Pajisjet mbrojtëse personale
PTS	Stacioni i pritjes së sondave
DNG	Depozitat Nëntokësore të Gazit Natyror

1 - HYRJE

Projekti i Depozitimit Nëntokësor të Gazit Natyror në Dumre (DNG Dumrea) është pjesë e Projektit të Vetëm të Tubacionit Kombëtar (PVTK) për periudhën 2017/2018, miratuar në mbledhjen e Komitetit Kombëtar për Investimeve (KKI) të datës 30 korrik 2018.

I gjithë gazi për konsum në të ardhmen në Shqipëri do të furnizohet nga Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP, i cili ka përfunduar dhe ka filluar operimin tregtar) dhe Gazsjellësi Adriatiko-Jonian (IAP). DNG Dumrea synon të përmirësojë dhe lehtësojë furnizimin me gaz në Shqipëri, dhe mundësisht në vendet e rajonit për të mbuluar pikun e kërkesave, për të balancuar ndryshimet sezonale dhe për të ndërlidhur furnizimin me gaz të vendeve të Ballkanit nga Lindja e Mesme dhe Rajoni i Kaspikut. Nëpërmjet lidhjes së DNG Dumrea në rrjetet rajonale të gazit, si TAP dhe IAP, Shqipëria mund të sigurojë struktura rajonale depozituese për vendet fqinje.

Sektori energjetik shqiptar do të përfitonte nga shtimi i një kapaciteti prodhimi jashtë pikut që do të ishte i disponueshëm me kërkesë, për të plotësuar prodhimin hidrik gjatë periudhave të kushteve të pafavorshme hidrologjike. Në Shqipëri, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përfituesi parësor përgjegjës për zbatimin e projektit.

Zona e interesit (poligoni i propozuar për planifikimin e DNG-së) për kavernën e depozitimit të gazit në formacionin kripor të Dumresë është përcaktuar në bazë të setit të dhënave të disponueshme në internet dhe të dhënave të ofruara nga institucionet shqiptare. Supozimet kryesore për vendndodhjen në nivel makro janë supozime gjeologjike për përcaktimin e pozicioneve optimale të kavernës së depozitimit të gazit. Në fazën e konceptimit të projektit janë analizuar parametrat e rëndësishëm gjeologjikë për vendndodhjet në nivel makro, si: zona ku kontrolli gjeologjik është më i mirë, ku formacioni kripor (haliti) është më i cekët, ku shtresat e halitit janë më të trasha dhe ku mund të arrihet burimi i ujërave të ëmbla për larjen e kavernës.

Kjo Përmbledhje Joteknike (PJT) shpjegon shkurtimisht rezultatet e VNMS-së dhe pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të përfituesit për t'u ofruar palëve të interesit informacion të qartë, të saktë dhe të mjaftueshëm në mënyrë që projekti të kuptohet si duhet. Janë bërë të gjitha përpjekjet për t'u siguruar se informacioni që përmban PJT-ja të jetë i saktë në kohën e publikimit.

1.1 - Arsyetimi i Projektit:

Objektivi kryesor i projektit të DNG-së së Dumresë është të kontribuojë në zhvillimin e sistemit shqiptar të gazit. Depozita nëntokësore e gazit mundëson uljen e kostos së përgjithshme të furnizimit me gaz për konsumatorët fundorë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shtesë në tregjet e gazit, si fleksibiliteti i ofertës dhe kërkesës, dhe krijimi i mundësive përkatëse të tregtimit.

Për depozitën vendore ekziston mundësia për rritjen e kapacitetit, ndërsa për depozitën rajonale kapaciteti maksimal i kërkuar i injektimit është 113,000 m^3/orë. Sasia maksimale e kërkuar e marrjes së gazit është 190,000 m^3/orë.

Për këtë kapacitet, janë përzgjedhur 3 kompresorë me pistonë që operojnë me motorë gazi, me kapacitet 1 x 20,000 m^3/orë dhe 2 x 50,000 m^3/orë. Kapaciteti minimal i një kompresori të vogël që operon në regjimin optimal është afërsisht 10.000 m^3/orë. Koha minimale e operimit të kompresorit me vënien në punë të tij është 8 orë rresht.

Sipas rastit, përzgjidhen dy njësi dehidratimi, me kapacitet 100.000 m^3/orë secila, me kapacitet minimal 15.000 m^3/orë për njësi. Koha minimale e operimit të njësisë së dehidratimit me vënien në punë të saj është 8 orë rresht.

1.2 - Qëllimi i Përmbledhjes Joteknike

Përmbledhja Joteknike (PJT) është një dokument konciz që paraqet përshkrimin e procesit të VNMS-së, gjetjet e tij dhe projektin në mënyrë të tillë që të jetë i lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar nga publiku i gjerë.

1.3 - Përshkrimi i përmbledhur i projektit të propozuar

Teknologjia dhe kapacitetet

Depozita nëntokësore e gazit natyror përfshin pjesën sipërfaqësore dhe nëntokësore. Pjesa nëntokësore është një strukturë gjeologjike (depozitime kripore shkëmbore), me kaverna dhe puse. Strukturat dhe impiantet që do të funksionojnë gjatë operimit të DNG-së do të ndërtohen në sipërfaqe të terrenit.

DNG Dumrea do të përfshijë stacionin e gazit, stacionin e matjeve, nënstacionin elektrik, zonën e pusit VL-1, zonën e pusit VL-2, stacionin e pompave për marrjen e ujit, tubacionet mbledhëse të gazit dhe korridoret e ujërave të ëmbla dhe të kripura, si dhe rrugët lidhëse që të çojnë në stacionin e gazit dhe zonat e puseve. Këto pjesë të DNG Dumrea janë subjekt i VNMS-së.

Pjesë e pandashme e DNG Dumrea është lidhja (dërgimi) e tubacionit të transmetimit të gazit TAP-DNG Dumrea, e cila është propozuar në nivel koncepti në kuadër të projektit për DNG Dumrea, por nuk është pjesë e ndonjë vlerësimi më mëtejshëm mjedisor dhe social (jo pjesë e kësaj VNMS-je).

Sipas gjetjeve nga analiza e ofertës dhe kërkesës për gaz, për DNG-në janë përcaktuar kërkesat e mëposhtme:

- Sasia maksimale e injektimit 113.000 m^3/orë,
- Sasia maksimale e marrjes së gazit 190.000 m^3/orë.

Presioni i gazit në depozitë dhe temperatura në puset e gazit

Sipas të dhënave nga projektimi i nëntokës/kavernës,

- Presioni minimal i gazit në kavernë është 60 bar,
- Presioni maksimal i gazit në kavernë është 180 bar,
- Temperatura e gazit në grykën e pusit: 28° C.

Pika e lidhjes në infrastrukturën e transportit të gazit

Lidhja e DNG Dumrea me infrastrukturën e transportit të gazit u mendua të ishte lidhja me TAP-in (drejtimi jugor). Pika e lidhjes së tubacionit lidhës të DNG Dumrea do të sigurohet në ABV30, që është struktura ekzistuese (stacioni i valvulave të bllokimit) në tubacionin e TAP-it në zonën e Urës Vajgurore (Kuçovë). Gjatësia e tubacionit lidhës do të jetë afërsisht 14.5 km.

1.4 - Qëllimi i procesit të VNMS-së

Qëllimi i raportit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) është të analizohet gjendja aktuale e çështjeve mjedisore dhe sociale, të përcaktohet ndikimi i projektit të planifikuar dhe të propozohen masa zbutëse dhe program monitorimi që do të zbuste ndikimet negative në nivele të pranueshme.

Në raportin e VNMS-së vlerësohet pranueshmëria e ndërhyrjes së planifikuar për çështjet mjedisore dhe sociale, në bazë të faktorëve që kushtëzojnë përhapjen, intensitetin dhe kohëzgjatjen e ndikimit.

2 - PREZANTIMI I PROJEKTIT DNG DUMREA

2.1 - Çfarë është projekti DNG Dumrea dhe ku ndodhet?

Depozita nëntokësore e gazit natyror të Dumresë përfshin strukturat gjeologjike nëntokësore (depozitat e shkëmbinjve të kripës) dhe strukturat sipërfaqësore (objektet dhe impiantet që do të vihen në funksion për operimin e DNG-së).

Depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre do të ndërtohet në një zonë në lindje të fshatit Vlashuk, të njësisë bashkiake Kozare, Bashkisë Kuçovë në Qarkun e Beratit, në pjesën qendrore të poshtme të Shqipërisë. Ajo është pjesë e zonës së Dumresë, me depozitime kripore shkëmbore me shtresë shumë të trashë (formacioni kripor shkëmbor i Dumresë), ku do të zhvillohen kavernat nëntokësore.

2.2 - Cilët janë komponentët/aktivitetet kryesore të Projektit?

Aktivitetet/operacionet e projektit

DNG-ja e Dumresë do të ndërtohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Faza e shpimit dhe larjes - objektivat kryesore për hapjen e puseve të reja që të arrijnë në formacionin kripor me thellësinë, trashësinë dhe me veçoritë gjeologjike dhe mekanike shkëmbore të përshtatshme për të larë kavernat për qëllimet e depozitimit të gazit,
- Operacionet ndërtimore (shtrirja e tubacionit, ndërtimi i rrugëve lidhëse dhe i infrastrukturës ndihmëse për të plotësuar kërkesat për energji elektrike, ujë, trajtim të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe ndërtimi i sistemit mbledhës)

Procesi teknologjik që do të kryhet pas ndërtimit në depozitën nëntokësore të gazit në Dumre konsiston në dy procese kryesore, të cilat lidhen në pjesë të caktuara, dhe janë:

- procesi teknologjik për injektimin e gazit të marrë nga sistemi i transmetimit të gazit në depozitimin nëntokësor,
- procesi teknologjik i marrjes dhe përgatitja për marrjen e gazit nga depozitimi për dërgim në sistemin e transmetimit të gazit.

Strukturat në funksion të operimit të depozitave nëntokësore të gazit natyror përfshijnë:

- lidhjen e gazit në tubacionin e sapondërtuar të gazit natyror, TAP, në tubacionin lidhës së gazit dhe në stacionin e matjeve,
- stacionin e gazit me impiantet kryesore dhe shtesë për përgatitjen e gazit për transport nëpërmjet rrjetit kryesor të gazit dhe për injektimin e gazit të marrë nga rrjeti kryesor i gazit në depozita,
- 2 sheshe pusesh me 2 puse të reja në total (për alternativën e dëshiruar të DNG-së),
- tubacionet mbledhëse nga sheshi i pusit deri në stacionin e gazit,
- nënstacionin elektrik.

Gjithashtu, për përgatitjen e pjesës nëntokësore të depozitës së gazit përfshihen:

- stacioni i pompave për marrjen e ujit, tubacionet e ujërave të ëmbla dhe të kripura.

Planimetria e përgjithshme e DNG Dumresë dhe vendndodhja e saj paraqitet në **Error! Reference source not found.**.

FIGURA 1 – VENDNDODHJA E DNG-SË SË PLANIFIKUAR TË DUMRESË



Lëndët e para/inputet, energjia, uji që do të përdoret

Punimet ndërtimore do të shoqërohen me nevojën për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, si dhe me prodhim të ujërave të ndotura (sanitare) dhe mbetjeve. Për furnizimin me energji elektrike nuk do të nevojitet lidhja në rrjetin shpërndarës, pasi do të përdoren burime portative të furnizimit me energji (gjeneratorë). Uji i pijshëm për punëtorët do të organizohet nëpërmjet dërgesave, në rast nevoje edhe në terren. Në shesh ndërtim nuk do të gjenerohen ujëra të ndotura, pasi do të sigurohen tualete portative për punëtorët dhe shkarkimi i tyre do të organizohet nga një shoqëri e licensuar.

Sasia e materialeve agregate, që do të nevojiten gjatë ndërtimit, përfshin:

- Dhera (nga gërmimet): 120,000 m^3
- Humus (për të mbuluar sipërfaqet e gjelbra): 12,400 m^2

Sasia e metaleve (tubave dhe pajisjeve) që nevojiten për ndërtimin do të jenë rreth:

- Tubacioni lidhës: 1.400.000 kg
- Pompat dhe tubacionet e stacionit të pompimit: 7.400 kg
- Korridoret e ujërave të ëmbla:
  - gjatë operimit VL-1: 37.000 kg
  - gjatë operimit VL-2: 9,000 kg shtesë (përmirësim)
- Tubacioni mbledhës dhe tubacioni i ujërave të kripura:
  - gjatë operimit VL-1: 109.000 kg
  - gjatë operimit VL-2: 89.000 kg
- Tubat dhe pajisjet brenda zonave të puseve: 41.000 kg
- Pika lidhëse (PTS): 88.000 kg
- Tubacionet e ujërave të kripura në Q. St-9:
  - gjatë operimit VL-1: 45.000 kg
  - gjatë operimit VL-2: 8,500 kg shtesë (përmirësim)

Sasitë e përafërta të materialeve të tjera janë:

- Beton (themele të ndryshme): 47,200 m^3
- Çelik dhe çelik i përforcuar (strukturat e çelikut mbrohen me mbrojtje kundër korrozionit): 900.000 kg
- Asfalt: 6,300 m^2
- Gjeotekstil (baza për ndërtimin e platformave dhe rrugëve): 7,850 m^2
- Bordura dhe kanale kulluese të parafabrikuara: 2.600 m
- Tuba (plastikë) të ujërave të zeza: 1.400 m
- Pllaka betoni të parafabrikuara: 2,900 m^2

Gjatë ndërtimit do të përdoret një sasi prej 1,800 m^3 naftë.

Pas ndërtimit, DNG Dumrea do të lidhet me sistemin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e shpërndarësit vendas të energjisë elektrike. Lidhja do të bëhet me tension mesatar. Propozohet të kërkohet një lidhje energjetike me fuqi prej 1 MW. Për nevojat sanitare (~ 300 l/ditë) po planifikohet ndërtimi i një depozite nëntokësore me kapacitetin e duhur, e cila do të mbushet përmes një autoboti. Me shumë mundësi, ujërat e ndotura të shiut nga qarkullimi dhe zonat manipulative, pas trajtimit në sheshin e ndërtimit, do të shkarkohen në vijat ekzistuese të ujit në afërsi të stacionit të gazit në përputhje me kushtet/kërkesat e pronarit/menaxherit (administrata shtetërore). Ujërat e ndotura sanitare do të shkarkohen në gropën e

grumbullimit që do të zbrazet me raste nga ndërmarrja e shërbimeve ose në njësinë e trajtimit biologjik të ujërave të ndotura.

Mbetjet që do të gjenerohen, lloji dhe sasia

Mbetjet që do të gjenerohet në sheshin e ndërtimit do të përbëhen nga mbetjet bashkiake dhe llojet e ndryshme të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Menaxhimi i mbetjeve do të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor dhe duke marrë në konsideratë direktivën ndërkombëtare dhe parimet e praktikës më të mirë. Të gjitha materialet e përdorura do të mblidhen, depozitohen dhe transportohen të ndara në kontejnerë të përshtatshëm dhe të miratuar. Pritet që gjatë ndërtimit një punëtor të gjenerojë rreth 1 kg mbetje bashkiake në ditë. Mbetjet e ngurta jo të rrezikshme që do të gjenerohen gjatë ndërtimit të shesheve të shpimit. Pritet që në sheshin e ndërtimit të gjenerohen sasi të vogla të mbetjeve dhe materiale të naftës për shkak të mekanizimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Llojet dhe sasitë e parashikuara të mbetjeve që mund të krijohen në shesh gjatë shpimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

TABELA 1 – LLOJET DHE SASITË E PARASHIKUARA TË MBETJEVE

Lloji i mbetjeve	Sasia	Metoda e asgjësimit
Llum dhe mbetje të tjera nga shpimi që përmbajnë ujë të kripur dhe mbetje	450 m^3	Kolektor i autorizuar
Vajra motorike, makine dhe lubrifikantë të paklorinuar me bazë minerale	1.850 l	
Ambalazhe letre dhe kartoni	950 kg	
Ambalazhe plastike (kuti, qese, najlon)	1.100 kg	
Ambalazhe druri (paleta, kuti druri)	1.100 kg	
Ambalazhe që përmbajnë mbetje të substancave të rrezikshme ose të kontaminuara me substanca të rrezikshme	950 kg	
Materiale përthithëse dhe filtruese (duke përfshirë filtra vaji, rrobë, peceta dhe material përthithës, veshje mbrojtëse e kontaminuar me substanca të rrezikshme)	850 kg	
Metale (pjesë pajisjesh, vegla)	2.100 kg	
Mbetje të përziera bashkiake	950 kg	

Llojet dhe sasitë e parashikuara të mbetjeve që mund të krijohen në sheshin e ndërtimit (strukturat sipërfaqësore dhe tubacionet shoqëruese të gazit) paraqiten në tabelën e mëposhtme.

TABELA 2 – MBETJET E NGURTA TË GJENERUARA GJATË NDËRTIMIT

Lloji i mbetjeve	Sasia	Metoda e asgjësimit
Vajra motorike, makine dhe lubrifikantë të paklorinuar me bazë minerale	6,550 l	Mbledhës i autorizuar
Ambalazhe letre dhe kartoni	6.950 kg	
Ambalazhe plastike (kuti, qese, najlon)	7.100 kg	
Ambalazhe druri (paleta, kuti druri)	6.700 kg	
Ambalazhe që përmbajnë mbetje të substancave të rrezikshme ose të kontaminuara me substanca të rrezikshme	3.650 kg	
Materiale përthithëse dhe filtruese (duke përfshirë filtra vaji, rrobë, peceta dhe material përthithës, veshje mbrojtëse e kontaminuar me substanca të rrezikshme)	5.950 kg	
Metale (pjesë pajisjesh, vegla)	10.250 kg	

Mbetje të përziera bashkiake	5.250 kg	

Pritet që me larjen të formohen kavernat nënsipërfaqësore për depozitimin e gazit. Një nënprodukt i procesit të larjes është uji i kripur, një solucion i pasur me ujë me kripë. Pas larjes, uji me papastërti nga kavernat (ujërat e kripura) transportohet në pusin e shkarkimit Stalin-9. Përllogaritet të prodhohet 10,905,568 m^3 (për të dy kavernat).

Kalendari i ndërtimit dhe operimit të projektit

Afati kohor për zhvillimin e projektit, së bashku me përfundimin, është rreth 7 vjet. Programi specifik i ndërtimit do të varet nga çështje të ndryshme teknike dhe kontraktuale. Punimet ndërtimore për strukturat sipërfaqësore mund të zgjasin për 2 vjet (duke punësuar 200 punëtorë). Është planifikuar që strukturat sipërfaqësore të kenë jetëgjatësi prej 30 vjetësh (faza operacionale), ndërsa tubacionet prej 50 vjetësh (faza operacionale).

Duke pasur parasysh llojin e projektit, pas përfundimit të fazës së operimit nuk do të ketë nevojë për sistemim lidhur me largimin e ndotësve nga toka dhe ujërat. Të gjitha aktivitetet e rigjenerimit lidhur me projektin do të përqendrohen te rigjenerimi i mbulesës bimore, që do të kryhet pas ndërtimit dhe çmontimit.

FIGURA 2 – KALENDARI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT



3 - ANALIZA E ALTERNATIVAVE TË MARRA NË KONSIDERATË

Ekipi mjedisor dhe social u përfshi që në fillim në procesin e përgatitjes së dokumentacionit të projektimit të projektit për DNG-në e Dumresë. Ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me projektuesit si dhe janë bërë disa rishikime të projektit/vendndodhjes me qëllim optimizimin. Optimizimi i vendndodhjeve të propozuara paraprakisht të puseve/kavernave solli zhvendosjen e kavernave jashtë zonës së rrezikuar ndaj përmbytjeve dhe akuiferit të lumit Devoll në terrenin që ngrihet në pjesën veriore të lumit.

Në kuadër të analizës së vlerësimit të alternativave, u analizuan tre variante. Krahas dy varianteve kryesore - DNG-ja lokale (2 kavernat) dhe DNG-ja rajonale (7 kavernat), u mor në konsideratë zhvillimi i ndarë në faza i DNG-së (faza 1 - 2 kaverna, faza 2- 5 kaverna shtesë). Duke marrë parasysh qasjen e hierarkisë së zbutjes me qëllim shmangien e krijimit të ndikimeve mjedisore ose sociale, dhe kur nuk është e mundur, zbatimin e masave shtesë që do të minimizojnë dhe zbusin ndikimet e mbetura, Varianti 1 - DNG-ja lokale shihet si më i pranueshëm dhe VNMS-ja është hartuar duke pasur parasysh këtë variant.

4 - TË DHËNAT BAZË MJEDISORE

4.1 - Karakteristikat e mjedisit fizik

4.1.1 - Klima dhe meteorologjia

Klima e Shqipërisë varion nga klima e ngrohtë në rajonet bregdetare perëndimore në klimën e ftohtë kontinentale në rajonet malore lindore dhe veriore të vendit. Kjo larmi llojesh të klimës është rezultat i efekteve të ndërthurura të pozicionit gjeografik në gjerësi mesatare, diferencave ndërmjet ultësirave në rajonet perëndimore dhe malore në lindje dhe veri dhe Detit Mesdhe të ngrohtë në perëndim.



Vendndodhja e projektit shtrihet në ultësirën qendrore, në të cilën mbizotëron klima mesdhetare me verë të nxehtë (Csa).

4.1.2 - Karakteristikat gjeologjike

Baseni i Durrësit shtrihet në mënyrë të papajtueshme në zonën joniane. Zona joniane është një brez i karakterizuar nga rrudhosjet dhe mbihipjet, që përmban shkëmbinj sedimentarë të llojit karbonat mesozoik dhe klastik kenozoik, të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës terciare. Struktura e Dumresë përbëhet nga volum shumë i madh i evaporiteve të Triasikut prej rreth 1,200–1,400 km^3 . Në sipërfaqe, sedimentet e Oligocenit rrethojnë evaporitet dhe zhyten nga jashtë në formacionin e zhveshur të Triasikut. Kufiri ndërmjet evaporiteve të Triasikut dhe sekuencave rrethuese është nënvertikal në jug dhe perëndim, ndërsa në veri dhe lindje zhytet butë (~ 30°) në kufijtë veriorë dhe lindorë.

Sipas hartës hidrogjeologjike të Shqipërisë (shkalla 1:200 000), zona e gjerë dominohet nga struktura evaporite Permo-Triasike. Masivi evaporit kufizohet nga depozitime flishore të Oligocenit. Pjesa më e ulët e terrenit zihet nga lumi i Devollit dhe lugina e tij aluviale, e cila përfaqëson akuiferin më produktiv të formuar nga zhavorri dhe rëra. Struktura evaporite e Triasikut dhe depozitat e Oligocenit mund të klasifikohen si

depozita pa akuifer. Të gjitha sitet e shpimit, si dhe strukturat në sipërfaqe ndodhen mbi depozitime pa akuifer (depozitime me përçueshmëri të ulët hidraulike).

4.1.3 - Gjeomorfologjia në zonat përreth DNG Dumrea

Në përgjithësi, zona e projektit pozicionohet në një rajon me fusha të ngritura me dinamika të ngritjes së lehtë. Në pjesën perëndimore të zonës, gjendet Rezervuari i Thanës me përrenj dhe kanale në afërsi të tij, nga ku terreni ngrihet disi drejt lindjes derisa arrin në lartësinë mesatare të zonës së projektit prej 100 m a.s.l. Pjesët më të ulëta të terrenit në jug dhe lindje të zonës së projektit zihen nga lumi i Devollit dhe fusha e tij aluviale. Relievi është kodrinor, me alternime të vazhdueshme majash të ulëta dhe luginash. Formacionet e theksuara karstike nuk janë të dukshme për shkak të pjesës së madhe të materialit të dheut. Dherat janë kryesisht përbërje me depozita të Triasikut. Në zonë ka disa gryka të formuara nga një ndërthurje e proceseve mikroteknike dhe erozioni i shkaktuar nga uji.

4.1.4 - Karakteristikat e peizazhit të mjedisit të gjerë rrethues

Zona e projektit pozicionohet në një rajon me fusha të ngritura me dinamika të ngritjes së lehtë. E gjithë zona mbizotërohet nga bujqësia. Përveç mozaikut bujqësor, karakteristikat kryesore të peizazhit janë një lymishtë në pjesën jugore dhe lindore, rezervuari në perëndim, shumë korridore përrenjsh, vendbanime të vogla sporadike dhe disa trupa ujorë të ndenjur në veri (liqene, rezervuarë dhe zona ujëmbledhëse). Krahas mozaikut bujqësor, korridoret e shumta të përrenjve krijojnë dinamikat pamore më të ndryshueshme, duke qenë se ato karakterizohen nga ulje të relievit. Kjo ndërthurje ka përvijuar peizazhin e një karakteri bujqësor dhe dinamika pamore të moderuara.

4.2 - Biodiversiteti dhe habitatet

Zona e projektit të DNG Dumrea as nuk shtrihet në zona të mbrojtura natyrore dhe as nuk ndodhet në afërsi të ndonjë zone të mbrojtur. Zona e projektit ndodhet e gjitha brenda rajonit biogjeografik mesdhetar. Klima e rajonit biogjeografik mesdhetar karakterizohet nga verë e nxehtë dhe e thatë, dhe nga dimër i lagësht dhe i freskët. Këto kushte klimatike kanë formësuar mbulesën e veçantë bimore. Zakonisht bimët përshtaten me kushtet e thatësirës dhe shpesh me shtresën e cekët të dheut. Numri i llojeve vendase është ende më i larti në Evropë, ku zona e gjerë mesdhetare është një nga dy pikat më të nxehta për llojet në Evropë. Po ashtu, ka një numër të lartë bimësh endemike, si dhe trashëgimtarë të egër të bimëve të kultivuara. Në rajonin biogjeografik mesdhetar, degradimi i pyjeve është shumë i pranishëm. Për të identifikuar zonat me vlera të larta të biodiversitetit, është kryer një eksplorim i detajuar i zonës më të gjerë. Hartëzimi i detajuar i habitatit përfshiu studimin krahasues të të dhënave të disponueshme vektoriale dhe raster si mbulimi i tokës CORINE 2018, llojet e habitatit sipas EUNIS, Harta Digjitale e Rajoneve Ekologjike Evropiane, imazheria ortofotografike digjitale, hartat topografike dhe hartat digjitale të terrenit. Brenda zonës së projektit janë identifikuar disa lloje habitatesh sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Natyrën (EUNIS).

TABELA 3 – LLOJET E HABITATEVE EUNIS TË IDENTIFIKUARA BRENDA KORRIDORIT TË PUNIMEVE TË TUBACIONIT PREJ 12 M

Kodi i habitatit EUNIS	Emri i habitatit EUNIS
C1	Ujërat e ndenjura sipërfaqësore
C2	Ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore
C3	Zonë litorale me trupa ujorë sipërfaqësorë të brendshëm
G2.9	Ullishta dhe pemëtore përherëblertë
G5	Breza pemësh, pyje të vogla antropogjenike, pyje të prera së fundmi, shkurre në fazë të hershme dhe korije
I1	Arë dhe kopsht perimesh për treg
I2	Sipërfaqe të kultivuara të kopshteve dhe parqeve
J2	Ndërtesa me dendësi të ulët
J2.43	Serra

Kodi i habitatit EUNIS	Emri i habitatit EUNIS
S3	Kaçuba të zonave me klimë të butë dhe malore mesdhetare
S5-2	Pseudomakiet submesdhetare
S9	Kaçuba breglumore dhe kënetash
SB.4	Vreshta
T1-1	T.1-1 Pyll breglumor i butë dhe boreal Salix dhe Populus
T1-4	Pyje breglumorë mesdhetarë dhe makaronezianë
T3	Pyll halor

Burimi: Agjencia Mjedisore Evropiane (https://www.eea.europa.eu/hr)

4.3 - Cilësia mjedisore dhe ndikimet ekzistuese

4.3.1 - Cilësia e ujit

Sipas Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm të Territorit të Bashkisë Kuçovë, (2016.), fshatrat në afërsi të Lumit të Devollit shkarkojnë direkt ujëra të ndotura urbane dhe rurale të patrajtuara në lum, duke e ndotur atë. Krahas ujërave të ndotura, Lumi i Devollit ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e industrisë së naftës dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tij. Në fakt, janë shpuar shumë puse nafte në distancë minimale nga lumi. Si rrjedhojë, cilësia e ujit të lumit është përkeqësuar gjatë viteve.

4.3.2 - Cilësia e ajrit

Shqipëria është një vend me infrastrukturë ende në zhvillim dhe urbanizim të konsiderueshëm (në vitin 2001, Shqipëria ishte një vend me 42 % popullsi urbane dhe 58 % rurale, ndërsa në vitin 2015 u shndërrua në një vend me 57 % popullsi urbane dhe 43 % rurale). Urbanizimi kërkon shumë energji dhe duke qenë se Shqipëria është vend në zhvillim, kjo energji vjen kryesisht nga lëndët djegëse që kanë ndikim negativ në cilësinë e ajrit. Analiza e përqendrimeve të ndotësve të ajrit zbuloi se rritja e qarkullimit është burimi kryesor i ndotjes në zonat urbane. Qarkullimi ndiqet nga djegia e biomasës, djegia e mbetjeve dhe emetimet industriale.

4.3.3 - Zhurma

Zhurma është një problem në rritje në Shqipëri. Në qytetet me densitet të madh popullsie janë regjistruar vlera të larta të zhurmës dhe për pasojë, popullsia e prekur nga zhurma në Shqipëri është e madhe. Po ashtu, është i dukshëm fakti se vlerat ditore për zhurmën urbane janë shumë të larta. Të gjitha vlerat mesatare janë mbi 65 dB. Vlera të larta të zhurmës janë regjistruar edhe gjatë natës. Projekti shtrihet në një zonë me dendësi të madhe të popullsisë dhe rrjedhimisht edhe vlera të larta të zhurmës.

4.3.4 - Menaxhimi i mbetjeve në zonën e projektit

Aktualisht, aktivitetet kryesore lidhur me menaxhimin e mbetjeve të ngurta në qarkun e Beratit përfshin grumbullimin, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve pothuajse në mënyrë të pakontrolluar. Ka vetëm pak aktivitete riciklimi të krijuara nga sektori privat. Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve nuk është i përshtatshëm për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave ekzistuese. Bashkitë po përballen me sfida për mundësimin e shërbimeve bazë të mbetjeve bashkiake, sidomos për mbledhjen dhe transportimin në zona rurale. Problemet vijnë për shkak të terrenit të vështirë, gjendjes së keqe të rrugëve që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin dhe zonat urbane, si dhe shpërndarjes së popullsisë, ndonëse të vogël, në zona malore. Praktika aktuale e asgjësimit të mbetjeve paraqet risk të lartë mjedisor pasi dy prej landfilleve më të mëdha bashkiake të vendit ndodhen në brigjet e lumit dhe asnjë prej tyre nuk është zonë sanitare.

4.4 - Baza socio-ekonomike

DNG-ja e planifikuar e Dumresë ndodhet në Kuçovë, në ultësirën qendrore të Shqipërisë, në rajonin e Verat, në lindje të vendbanimit të Vlashukut. Zona e projektit të DNG Dumresë është e mirëpozicionuar, nuk ka vendbanime në afërsi dhe tubacionet (tubacionet mbledhëse, të ujërave të kripura, të ujit të pijshëm) kalojnë

kryesisht përmes tokave bujqësore. Ky pozicionim është më i pranueshëm, ndonëse sjell kufizime për banorët gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të projektit. Godinat në pjesën lindore të vendbanimit të Vlashukut, në pjesën perëndimore të projektit janë godina dhe shtëpi private. Distanca nga pusi VL-2 në objektin më të afërt privat në vendbanimin e Vlashukut është mbi 700 m

Tabela e mëposhtme paraqet njësitë administrativo-territoriale përpara dhe pas reformës administrativo-territoriale 2014/2015, duke marrë në konsideratë zonën e interesit të DNG Dumrea.

TABELA 4 – NJË REFORMË ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE PËR ZONËN E INTERESIT TË PROJEKTIT

Vendi-Qarku-Bashkia përpara reformës /	Vendi-Qarku-Bashkia përpara reformës /
